



Universiteti "Ukshin Hoti"
University "Ukshin Hoti"
Prizren

KËSHILLI DREJTUES

Universiteti i Prizrenit University of Prizren Universitetet Prizrena "UKSHIN HOTI"	
Pranuar më datë 16.06.2023	
Zyra e pranimit	Nr. i protokolit
308	01-364

Rruga e Shkronjave nr.1 20 000 Prizren-Kosovë ; Tel :+383 (0) 29 232 140 ; Homepage :www.uni-prizren.com

Këshilli Drejtues

nr. ref. _____

Prizren, më 16.06.2023

Bazuar në dispozitat e nenit 17, paragrafi 1 dhe 2 dhe nenit 154 të Statutit të Universitetit nr. 04-V-621 të datës 30.05.2013, si dhe duke u bazuar në nenin 11 të Rregullores për zgjedhjet e studentëve, nr. 01-34, të datës 09.02.2018, Këshilli Drejtues, në takim të mbajtur më datën 16.06.2023 në lidhje me organizimin e procesit të zgjedhjeve të studentëve, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Shpallen zgjedhjet për Parlamentin e Studentëve dhe Këshillet e Studentëve në të gjitha njësitë akademike të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren.
- II. Zgjedhjet për Parlamentin e studentëve dhe Këshillet e Studentëve zyrtarisht fillojnë më datë 16.06.2023 dhe përfundojnë sipas dinamikës së përcaktuar nga Këshilli Drejtues, më së largu më 17.07.2023.
- III. Procesi i votimit për zgjedhjet e studentëve i paraparë sipas dinamikës zgjedhore për datën 10.07.2023, do të realizohet në mënyrë elektronike përmes Sistemit të Menaxhimit Universitar (SMU).
- IV. Zgjedhjet e studentëve bazohen në dispozitat e Statutit të Universitetit, rregullores nr. 01-34, dt.09.02.2018, me plotësim ndryshimet sipas vendimit të KD-së si dhe në dinamikën e miratuar të zgjedhjeve për vitin 2023.
- V. Përgatitjet teknike të realizimit të procesit të votimit të studentëve të Universitetit në mënyrë elektronike bëhen në koordinim të plotë ndërmjet KQZ-së, përfaqësuesit të autorizuar të SMU-së dhe zyrës së IT-së së Universitetit.
- VI. Obligohet KQZ që në bashkëpunim me përfaqësuesit e autorizuar të SMU-së të nxjerrë manualin për mënyrën e votimit elektronik në SMU.
- VII. Të gjitha palët që angazhohen në këtë proces zgjedhor, duhet të tregojnë korrektësi dhe të veprojnë në përputhje me vlerat demokratike.
- VIII. Ftohen të gjithë përfaqësuesit e shoqërisë civile të Republikës së Kosovës, KQZ-së, OSBE-së, misionet diplomatike në Kosovë si dhe të gjitha mediat e shkruara dhe elektronike që të jenë vëzhgues dhe të monitorojnë zgjedhjet e studentëve në Universitetin "Ukshin Hoti" Prizren.
- IX. Ky vendim dhe çdo dokument tjetër i zgjedhjeve studentore të vitit 2023 duhet publikuar në faqe ueb të Universitetit "Ukshin Hoti", Prizren.
- X. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Vendimi i dërgohet:

- MASHTI-t
- Këshillit Drejtues
- Menaxhmentit
- Sekretarit të Përgjithshëm
- Parlamentit të Studentëve dhe
- Arkivit

